



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/73

Datë: 30.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Tubime Publike.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry Of Internal Affairs

KONCEPT DOKUMENT PËR TUBIME PUBLIKE

Shtator 2018

Kapitulli 1: Hyrje

Koncepti dokumenti për Tubime Publike kontribuon në forcimin e prioritetit strategjik të Qeverisë nr. 1 "Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit" të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë 2018, si dhe me objektivin nr. 2 "Ruajtja e sigurisë publike dhe përmirësimi i shërbimeve për qytetarët" i Planit Vjetor të Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të vitit 2018, me saktësisht aktivitetin 2.2 "Avancimi i politikave në fushën e sigurisë publike". Hartimi i këtij koncepti dokumenti parashihet edhe në Planin Vjetor për Hartimin e Konceptit Dokumenteve për vitin 2018.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes /problemit kryesorë

Shpjegim

Gjatë zbatimit të ligjit ekzistues për tubime publike, institucionet e zbatimit të ligjit kanë hasur në vështirësi të shumta për arsye të zbrazëtirave ligjore në këtë ligj. Më saktësisht, disa prej masave ndëshkuese të specifikuara në ligjin ekzistues, siç janë masat ndëshkuese për bartjen e armës, nuk janë në përputhje me masat ndëshkuese në Kodin Penal. Po ashtu, me ligjin për tubime publike nuk është i rregulluar shkaktimi i rrezikimit të përgjithshëm sipas nenit 365 të kodit penal të Republikës së Kosovës.

Ky problem është paraqitur që nga nxirrja e këtij ligji, por me e theksuar ka qene gjate viteve 2012, 2013 dhe 2014. Ndërsa grupet e prekura nga ky koncepti dokument janë: Policia e Kosovës, gjykatat dhe ndërmarrjet private.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të këtij ligji është hasur në vështirësi edhe në interpretimin e dispozitave shpjeguese dhe përkufizimeve, posaçërisht të përkufizimit për **Tubimet publike** që definohen si "tubime të hapura të qytetarëve të organizuara nga grupe, entitete, OJQ, subjekte politike etj, në të cilat festohet, jepen shfaqje apo shprehet brenga dhe pakënaqësia për çështje të ndryshme" dhe **Dhuna**, që përkufizohet si "dhuna e ushtruar nga një grup i konsiderueshëm pjesëmarrësish e jo nga individët e veçantë, kundër njerëzve ose objekteve tjera", si dhe përkufizimeve tjera.

Mos-përcaktimi i saktë llojeve të tubimeve publike sa i përket lirisë së tubimeve publike, manifestimeve, parakalimeve, ngjarjeve sportive, protestave dhe përkujtimeve të qeta, si dhe mungesa e kufizimit dhe ndalimi i tubimit publik, përfshirë edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e subjekteve që i organizojnë dhe marrin pjesë në këto tubime janë ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen institucionet relevante. Po ashtu, ekzistojnë mangësi të dukshme sa i përket detyrave dhe përgjegjësi të Policisë së Kosovës lidhur me tubimet publike.

Ligji momental nuk përmban dispozita që i ndalojnë edhe keqpërdorimin e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara për organizimin e tubimeve publike, si dhe detyrimin e punëtorëve me force për pjesëmarrje në tubime publike. Gjithashtu mungojnë edhe sanksionet që kanë të bëjnë me organizimin e garave apo luftërave të qeneve, gjelave dhe kafshëve të tjera.

Korniza ligjore nuk është e harmonizuar me legjislacionin evropianë sa i përket lirisë dhe të drejtave në tubime publike.

Problem tjetër që ka nevojë për konkretizim të mëtutjeshëm është edhe mbajtja e armeve nga pjesëmarrësit në tubime publike e cila është e ndaluar pavarësisht posedimit të lejes për mbajtje të armës apo jo.

Informata

Politika aktuale

Politikat aktuale lidhur me tubimet publike janë të rregulluara me Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubime Publike si dhe me ligjet dhe akte nënligjore që ndërlidhen me fushën e tubimeve publike si janë: Ligji për Rend dhe Qetësinë Publike, Ligjin për Policinë, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Kundërvajtje etj.

Çdo tubim publik duhet detyrimisht të lajmërohet nga organizatori apo përfaqësuesi i tij nën kushtet dhe afatin e paraparë nga ligji. Lajmërimi bëhet më së voni shtatëdhjetë (72) orë para se të mbahet tubimi i qetë publik. Policia e Kosovës duhet që më së voni dyzet e tetë (48) orë para mbajtjes së tubimit publik të lajmërojë organizatorin për lejimin apo ndalimin e tubimit publik. Organizatori apo lajmëruesi i tubimit publik i pakënaqur me vendimin e organit që ka

ndaluar tubimin publik mund të ankohet brenda tri (3) ditëve para gjykatës kompetente për shqyrtim të rastit. Gjykata në këtë rast vendos me procedurë të shpejtuar.

Sa i përket tubimeve publike me karakter komercial, kulturor, sportiv apo promovues, me ç' rast do përdoren hapësirat publike për të vendosur tenda, tezga, apo instalime të ndryshme audio-vizuele, komunat japin leje për shfrytëzimin e hapësirave publike, gjë që rregullohet me rregulloret komunale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Policia e Kosovës ka miratuar PSO-në me nr. referues DDO - 04/ 026/ 2013 e cila është në harmoni me ligjin për tubime publike me titullin "Sigurimi Policorë në manifestime publike, kulturore e sportive" me anë të së cilës është e rregulluar çështja e paraqitjes ose lajmërimit të tubimeve publike dhe aktiviteteve tjera në Polici si dhe angazhimit policorë në aktivitetet në fjalë.

Numri i tubimeve publike (protesta të dhunshme apo të qeta, manifestime, koncerte etj.) për periudhën 2014, 2015, 2016 dhe 2017, në terë territorin e RKS-së.

DRP	Lloji i tubimit	2014	2015	2016	2017	Gjithsejtë
Prishtinë	Protesta të dhunshme apo të qeta	151	176	143	78	548
	Manifestime, koncerte	174	225	367	231	997
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	214	39	28	556	837
	PRQP	432	376	406	473	1687
Gjilan	Protesta të dhunshme apo të qeta	4	17	6	9	36
	Manifestime, koncerte	163	174	190	256	783
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	127	0	0	426	553
	PRQP	115	123	104	152	494
Ferizaj	Protesta të dhunshme apo të qeta	20	33	8	18	79
	Manifestime, koncerte	24	23	12	20	79
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	186	0	0	465	651
	PRQP	262	204	198	166	830
Prizren	Protesta të dhunshme apo të qeta	38	12	18	23	91
	Manifestime, koncerte	53	55	56	54	218
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	265	0	0	610	875
	PRQP	95	102	73	96	366
Gjakovë	Protesta të dhunshme apo të qeta	11	36	15	13	75

	Manifestime, koncerte	38	42	49	45	174
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	214	0	0	688	902
	PRQP	155	105	113	103	476
Pejë	Protesta të dhunshme apo të qeta	17	36	28	21	102
	Manifestime, koncerte	34	38	45	70	187
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	218	0	0	519	737
	PRQP	169	183	182	166	700
M.Jugu	Protesta të dhunshme apo të qeta	16	23	28	18	85
	Manifestime, koncerte	174	179	115	92	560
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	113	0	4	333	450
	PRQP	302	276	275	241	1094
M.Verri	Protesta të dhunshme apo të qeta	19	11	5	6	41
	Manifestime, koncerte	157	173	191	199	720
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	7	0	2	38	47
	PRQP	223	99	86	84	492
TOTAL	Protesta të dhunshme apo të qeta	276	344	251	186	1057
	Manifestime, koncerte	817	909	1025	967	3718
	Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	1344	39	34	3635	5052
	PRQP	1753	1468	1437	1481	6139

Numri i tubimeve publike për periudhën 2014, 2015, 2016 dhe 2017, në tërë territorin e RKS-së sipas llojeve.

Lloj i tubimit	2014	2015	2016	2017	Gjithsejtë
Protesta të dhunshme	13	6	5	41	65
Protesta të qeta	249	293	230	165	937
Sa prej tyre kanë qene te lajmëruara.	244	287	228	160	919
Sa prej tyre nuk janë lajmëruar.	19	12	8	6	45
Tubimet për fushata elektorale-zgjedhje	986	53	47	2577	3663
Sa tubime nuk janë lejuar nga policia pas lajmërimit te rregullt.	0	0	0	2	2

Sa gjoba/kallëzime janë shqiptuar për moslajmërim te rregullt	2	1	0	0	3
Sa gjoba/kallëzime për organizim te tubimit te ndaluar	0	0	0	0	0
Sa gjoba/kallëzime për organizatoret qe nuk e kane ndërprerë tubimin/protestën publike vetvetiu apo me kërkesë te policisë (neni 13, para 3 dhe 7)	5	2	0	0	7
Sa kallëzime penale për personin i cili mban armë apo shet alkool në vendin e tubimit	0	0	0	0	0
Sa kallëzime penale personin i cili në tubimin e qetë publik mbanë apo bartë mbishkrime, apo gjësende të tjera me të cilat nxitet apo ftohet për dhunë apo urrejtje ndërnacionale, politike, fetare, racore apo të ngjashme	4	3	0	4	11

Konsiderojmë se konceptet janë të ndara rreth asaj qe i takon policisë së Kosovës - ofrimi i sigurisë - dhe asaj që i takon komunës - dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave publike për çështje të ndryshme.

Sigurisht që në procedurat tjera, gjatë hartimit të Ligjit duhet të rregullojmë mënyrën e bashkëpunimit, qoftë kur organet e Komunës japin pëlqime t'i njoftojnë palët dhe zyrtarët e policisë së Kosovës si dhe kur zyrtarët e policisë japin leje për mbajtje të protestave t'i njoftojnë edhe organet e Komunës.

Nga praktika rezulton se personat juridik apo fizik te cilët planifikojnë ndonjë aktivitet kulturor, komercial apo sportiv, kanë për detyrë që fillimisht ta marrin pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike sipas Rregullores për Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike nga Komuna në zonën e së cilës është paraparë aktiviteti dhe njëkohësisht duhet të dorëzojnë apo dërgojnë një njoftim me shkrim për Policinë lidhur me aktivitetin që do të zhvillohet. Agjenda e plotë duhet te sillet në Polici dhe të pritët leja nga policia dhe nëse nuk ka përgjigje nga policia pas afatit 48 orësh para tubimit, atëherë tubimi konsiderohet i lejuar. Policia (Stacioni Policor) me këtë rast plotëson formularin mbi paraqitjen e aktiviteteve kulturore apo çfarëdo qofshin ato (formulari gjendet në PSO-në në fjalë) dhe të

njëtin e dërgojnë për miratim në instanca më të larta të Policisë (sipas hierarkisë komanduese). Pas miratimit apo refuzimit, njoftohet paraqitësi i kërkesës.

Po ashtu, neni 11 i ligjit Nr. 03/L-118 për tubime publike e ndalon mbajtjen apo shitjen e alkoolit në tubime apo protesta publike. Ky nen duhet të specifikojë se a vlen edhe për aktivitete kulturore, humanitare, sportive, fetare, dhe argëtuese të cilat gjithashtu konsiderohen si tubime publike.

Komunat duke u bazuar ne *Ligjin për Vetëqeverisje Lokale* dhe Statutet e tyre lëshojnë sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik pëlqime për aktivitete publike (manifestimeve publike, kulturore dhe sportive). Me saktësisht, ligji parasheh se një ndër kompetencat vetanake të komunave është edhe ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike, që nënkupton se pastaj komuna me akte nënligjore i rregullon procedurat dhe mënyrën e menaxhimit, dhënien në shfrytëzim dhe çdo gjë që lidhet me hapësirat publike qoftë për çështje komerciale, humanitare, promovuese kulturore e sportive etj.

Për më tepër, Ligji Nr. 03/L-049 *për Financat e Pushtetit Lokal* komunave iu përcakton obligimet që kanë për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve publike brenda territorit të komunës.

Përveç informatave të lartcekura, policia e Kosovës është angazhuar në ngritjen e vetëdijesimit për pasojat e tubimeve të dhunshme. Aktivitetet për ngritjen e vetëdijesimit tek grupet e interesit përfshijnë: shpërndarja e broshurave, kampanjat e ndryshme televizive, dhe takimet direkte me organizatore dhe qytetare.

Ligjet dhe aktet nënligjore

- **Ligji Nr.03/L-118 për Tubimet Publike**, Me këtë ligj rregullohet e drejta për tubime publike, e fjalës së lirë në tubime publike, protestave, manifestimeve publike, koha dhe mënyra e lajmërimit, detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve.
- **Ligji Nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësin Publike**

Qëllim i këtij ligji është rregullimi i sjelljes personale në mënyrë që të ruhet rendi dhe qetësia publike. Aktualisht, është duke u hartuar koncept dokumenti për rend dhe qetësi publike i parapare në listën e koncept dokumenteve për vitin 2018.

Paragrafi 3 i nenit 4 të këtij ligji përcakton se: Nëse kundërvajtja e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, kryhet ndaj personave zyrtar ose personave tjerë që mbrojnë rendin dhe qetësinë publike sipas ligjit në fuqi për tubimet publike, ai/ajo do të dënohet me gjobë prej njëqindpesëdhjetë (150) deri nëntëqind (900) Euro apo me dënimin me deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

Paragrafi 3 i nenit 5 të këtij ligji përcakton se: Nëse kundërvajtja e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, kryhet ndaj personave zyrtar ose personave që mbrojnë rendin dhe qetësinë publike sipas ligjit të në fuqi për tubimet publike, ai/ajo do të dënohet me gjobë prej njëqind (100) deri shtatëqind (700) Euro apo me dënimin me burg deri në pesëdhjetë (50) ditë.

Neni 14 paragrafi 2 i këtij ligji përcakton se: Kushdo që me dashje shkakton panik në tubime publike, duke lajmëruar rrejtshëm për alarm nga zjarri dhe për kërcenim me bombë, do të dënohet për kundërvajtje.

- **Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës**

Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

Neni 25 paragrafi 2 i këtij ligji përcakton se: Policia është e autorizuar t'i përdorë incizimet video-akustike dhe fotografitë për të vëzhguar dhe mbledhur informacione në një tubim publik atëherë kur ka arsye të bazuar se tubimi publik mund t'i rrezikoj personat apo pronën.

Neni 49 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 përcakton se: Personeli policor nuk do të pranojë një pozitë apo obligim, dhe nuk do të jetë pjesëmarrës në çfarëdo funksioni apo aktiviteti, i cili krijon konflikt të interesave me detyrat zyrtare të policisë. Pozitat dhe aktivitetet që formojnë konflikt të interesave përfshijnë por nuk kufizohen me: pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike, ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore;

paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore (anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesave)

- **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**

Ky ligj themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Bazuar në neni 68 .1 Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara.

- **Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje**

Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës. Sanksioni për kundërvajtje mund të parashihen vetëm në pajtim me këtë ligj.

- **Ligji Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë**

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i të gjitha aktiviteteve në fushën e sigurisë private mirëpo, dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në aktivitetet që rregullohen me ligjin për policinë dhe aktivitetet e tjera të sigurisë që u janë caktuar institucioneve shtetërore dhe qeveritare.

Neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 përcakton se: Shërbimet e sigurimit mund të ofrohen në shërbimet e sigurimit të tubimeve publike, neni 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 përcakton se: Standardet profesionale të Kosovës që hartohen nga organi kompetent përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në Standardet profesionale të Kosovës që hartohen nga organi kompetent përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në standardet për shërbimet e sigurimit të tubimeve publike, neni 10 paragrafi 1.15 përcakton se: Kompania private e sigurimit mund të aplikojë për licencë që të ofrojë shërbimet e sigurimit të tubimeve publike dhe neni 13 paragrafi 4 përcakton se: Për t'u pajisur me licencën për ofrimin e shërbimeve të sigurimit të tubimeve publike

aplikuesi, përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji duhet: të ketë qendrën e certifikuar të kontrollit; dhe të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë të rëndomtë të sigurimi

Ministria e Punëve të Brendshme në programin legjislativ në programin për vitin 2018 ka parapare plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji. Andaj me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për tubime publike duhet të harmonizohet neni 9 dhe neni 12 i ligji për shërbimet private të sigurisë.

- **Ligji Nr. 05/L -022 për Armë**

Rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizik dhe juridik, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuara vetëm për përdorim civil. Në ligjin aktual nuk është e rregulluar ndalimi i mbajtjes së armës së zjarrit në tubimet publike. Individët që kane leje për arme mbajtje duhet t'ju ndalohej që t'i bartin ato në tubimet publike.

- **Ligji Nr. 05/I-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive**

Përcaktohen masat për parandalimin, sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, obligimet e organizatorit të ngjarjeve sportive, kompetencat e organeve zyrtare për shqiptimin e masave për parandalimin, sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, kurdisjeve dhe dukurive tjera. Neni 6 paragrafi 1 përcakton se: Organizatori i ngjarjes sportive është i obliguar të angazhojë shërbimin kujdestar adekuat, ose të angazhojë personin juridik, që t'i kryej shërbimet për siguri fizike dhe ruajtjen e rendit në ngjarjen sportive gjithashtu paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: Organizatori është i obliguar që të sigurojë hapësira të veçanta në objektin sportiv për organet e tjera kompetente si: policia, shërbimi mjekësor, zjarrfikësit dhe organet e tjera që ofrojnë shërbime publike. Neni 12 nën-paragrafi 1.6 përcakton se: Organizatori duhet të sigurojë që ngjarja sportive me rrezikshmëri të lartë të zhvillohet në objektin ku janë të siguruara kushtet vijuese: të ketë hapësirën e caktuar për anëtarët e Këshillit, personin e autorizuar nga Policia e Kosovës dhe zyrtarët kompetentë për ruajtjen e rendit dhe

qetësisë në ngjarjen sportive. Këta persona, nga kjo hapësirë, duhet të kenë shikim të qartë të terrenit dhe të tifozëve – pjesëmarrësve.

- **Ligji Nr. 02/l-102 për Mbajtjen nga Zhurma**

Përcakton se me rastin e plotësimit të nevojave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla. Me të njëjtin vendim përcaktohen edhe rrugët e shkuarjes e ardhjes të pjesëmarrësve nga këto manifestime.

Neni 15 paragrafi 1 përcakton se: Me rastin e plotësimit të nevojave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë 6 lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla.

- **Ligji nr. 05/l-088 për rregullat e trafikut rrugor**

Ky ligj ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor, kushtet bazë që duhet t'i plotësojnë rrugët nga aspekti i sigurisë rrugore, sistemin e sinjalizimit të trafikut rrugor, shenjat që i japin personat e autorizuar zyrtarë, detyrat në rast aksidenti në trafikun rrugor, kushtet për drejtim të mjetit, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen t'i kenë mjetet, dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkesën boshtore të mjetit, si edhe kushtet të cilat duhet t'i plotësojë mjete në trafikun rrugor.

Neni 224 paragrafi 1 përcakton se: Organizatori duhet ta ndërpresë mbajtjen e manifestimit sportiv apo të ndonjë aktiviteti tjetër në rrugë, në rast se prishet në masë të madhe rendi dhe qetësia publike.

- **Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës**

Neni 147 paragrafi përcakton se: Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Neni 162 i kodit penal përcakton se: Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, xhirimeve audio vizuele ose në ndonjë mënyrë tjetër thërret ose nxit për luftë agresive apo konflikt të armatosur, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet

Neni 207 përcakton se kushdo që me përdorimin e mashtrimit ose në ndonjë mënyrë tjetër parandalon ose pengon caktimin apo mbajtjen e tubimit publik në të cilin personat kanë të drejtë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

- **Ligji Nr. 04/L-022 Për Përdorim Civil Të Eksplozivëve**

Neni 32 paragrafi 12 i këtij ligji përcakton se: në rast të rrezikimit të sigurisë publike dhe për të parandaluar posedimin dhe përdorimin ilegal të eksplozivëve, ministria mund të kufizoj ose të ndaloj importin eksportin transitin ose transferimin e eksplozivëve. Paragrafi 13 ne këtë ligj përcakton se Ministria përkohësisht mund të kufizojë ose të ndalojë transferimin e eksplozivëve apo fishekzjarrëve në tërë territorin, ose në një pjesë të territorit të Kosovës, më qëllim të ruajtjes së sigurisë publike.

- **Ligji Nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike Të Prizrenit**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Neni 21 paragrafi 2 i këtij ligji përcakton se: kërkesat për tubime publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit lejohen pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria për Shërbime Publike

Aktet nënligjore

- **Udhëzim Administrativ Nr. 02/2013 për Mënyrën e Ofrimit të Ndhmës Organeve Qeveritare nga Policia e Kosovës** përcakton rregullat, mënyrat, format dhe procedurat e ofrimit të ndihmës nga Policia e Kosovës institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe lokal, si dhe institucioneve ndërkombëtare.
- **Rregullorja për Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike**, përcakton llojet e objekteve të përkohshme kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimi dhe largimi i objekteve në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes. Objekte të përkohshme, konsiderohen, tendat e hapura lëvizëse, me mekanizëm dhe me elemente montuese nga materiali pleksiglas.
- **Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 03/2016 për Leje për Lëvizje me Armë** përcakton procedurat dhe kriteret për lëshimin dhe përdorimin e lejes ndërsa sa i përket lëvizjes me armë, neni 3 i këtij udhëzimi administrativ përcakton se: leja për lëvizje me armë i lëshohet personit juridik dhe personit fizik nga organi kompetent, me të cilin personit juridik i njihet e drejta e lëvizjes nga depoja në vendin për gjah, shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport për armët e koleksionit të lejuara me leje përkatëse ose për ekspozitë, kurse për personin fizik me leje përkatëse për armë i njihet e drejta për lëvizjen nga vendbanimi i personit fizik në vendin për gjah ose shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport të armëve të koleksionit për ekspozitë.
- **Udhëzimi Administrativ nr. 11/2012 - (MPB) mbi Masat, Autorizimet dhe Detyrat e Kompanive Private të Sigurimit Neni 1** i këtij udhëzimi administrativ përcakton se: Kompanitë private të sigurimit të licencuara në fushën e shërbimeve të sigurimit të tubimeve publike, janë të autorizuara të kryejnë aktivitetet operacionale vlerësojnë rrezikun dhe hartojnë planin e sigurisë, bëjnë organizimin dhe përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të sigurisë për kryerjen e detyrave për sigurimin e tubimeve publike në bazë të planit të hartuar të sigurisë, të propozojë masa të obligueshme dhe shtesë sigurie organizatorit të tubimit, përgatitë dhe zbatojë planet alternative në rast se tubimi publik bëhet jopaqësore deri në marrjen e kontrollit nga policia, si dhe detyrat dhe obligimet tjera të parapara me ligj.

- **Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 15/2017 Për Procedurën e Kundërvajtjes në Trafikun Rrugor** Neni 24 i këtij udhëzimi administrativ përcakton se: Statistikat e të dhënave të kundërvajtjeve në fushën e sigurisë në trafikun rrugor dhe informacionin mbi aksidentet e trafikut mund t'i përdorin institucionet shkencore, mediat dhe organet e tjera që merren me çështjet e sigurisë në rrugë, si dhe personat fizikë dhe juridikë të angazhuar në transportin publik për nevojat e tyre, apo që merren me hulumtime/kërkime shkencore, pas marrjes së pëlqimit nga MPB-ja.

Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 00/2017 për Vendosjen e Pajisjeve të Veçanta Sinjalizuese në Automjete Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave për mënyrën e vendosjes dhe përdorimit të pajisjeve të veçanta sinjalizuese në mjetet nën përcjellje mjetet me përparësi kalimi dhe në mjetet e ndërmarrjeve apo kompanive që kryejnë shërbime publike, llojet e pajisjeve sinjalizuese dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e këtyre pajisjeve, si dhe obligimet e pjesëmarrësve tjerë në trafik ndaj mjeteve të cilat i kanë të aktivizuara këto pajisje sinjalizuese.

Paragrafi 1 ne paragrafi 1.6 i nenit 6 te këtij udhëzimi administrativ përcakton se: Dritat e verdha vezulluese vendosen në: mjetin për përcjelljen e aktiviteteve sportive, manifestimeve apo tubimeve të ndryshme;

Paragrafi 2 i nenit 11 te këtij udhëzimi administrativ përcakton se: Përdorimi i pajisjeve të veçanta sinjalizuese bëhet edhe në rast të aksidenteve të shkaktuara në trafikun rrugor, pastaj në rast të fatkeqësive natyrore, tërmetejeve, vërshimeve, tubimeve apo manifestimeve të ndryshme, aktiviteteve sportive, në rast të ndalimit apo bllokimit të qarkullimit në trafikun rrugor, si dhe në raste ose rrethana tjera që paraqesin pengesa për zhvillimin normal në trafikun rrugor.

Shpenzimet aktuale

Tabela e Shpenzimeve aktuale

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimet faktike ne vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: Policia e Kosovës-Operacionet Speciale	1,886,893.00 €	1,690,393.00 €	1,690,393.00 €
Shpenzimet tjera: Demet ne pronën publike, demet ne pronën private, Lëndimet e policeve, Pagesa jashtë orarit të punës, Karburantet, Ushqimi.	308,285.29 €	----	----
Financimi nga Donatorët	442,743.42 €	4,652.72 €	-
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	----	----	----

Përvija në vende të tjera

Vendet e BE-së dhe të rajonit janë të gjitha nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹, si dhe konventave e kartave tjera që garantojnë të drejtën e tubimit paqësor të qytetarëve. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në NENIN 11: Liria e tubimit dhe e organizimit, përcakton se “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme

¹ (Council of Europe, 1950), European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, as amended by Protocols Nos. 11 and 14, 4 November 1950, ETS 5.: http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”

Për hartimin e këtij koncept dokumenti janë konsultuar disa dokumente krahasuese të hartuara nga institucione të ndryshme^{[2][3]}, si dhe udhëzuesi i Komisionit të Venedikut dhe Zyrës së OSBE për të Institucione Demokratike dhe të drejta të Njeriut (ODIHR) për Lirinë e Tubimit^[4]. Për më tepër, janë shikuar në detaje edhe disa ligje të shteteve të rajonit, siç janë ligji i Sllovenisë dhe ai i Kroacisë për këtë çështje.

Ne kuadër të kushtetutës së shtetit Slloven, tubimet publike janë të garantuara me kushtetute dhe ligj. Tubimet publike janë të ndaluara vetëm në rastet kur pengojnë dhe kërcënojnë sigurinë publike, me saktësisht ato tubime të cilat shkaktojnë dhunë, prishin rendin publik ose pengojnë trafikun publik. Për më tepër, ndalohen tubimet dhe ngjarjet publike në ambientet e hapura në afërsi të objekteve të cilat janë të mbrojtura sipas legjislacionit. Autoritetet kompetente mund të ndalojnë mbledhjet publike në rast se organizatori nuk ka demonstruar dëshmi të mjaftueshme për sigurimin e rendit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të pjesëmarrësve dhe personave të tjerë, mbrojtjen e pronës, sigurinë e trafikut publik, mbrojtjen e mjedisit, kushtet e duhura të pajisjeve ose përdorimin e sigurt të objekteve të cilat në raste të caktuara mund të paraqesin rrezik për jetën, shëndetin dhe pronat private.

Për më tepër, në Kroaci, bazuar në ligjin për tubime publike, në nenin 1 të këtij ligji ceket se çdokush ka drejta për tubime publike. Tubimet publike definojnë si tubime paqësore, demonstrata publike, manifestime publike dhe forma të tjera të tubimeve. Në bazë të këtij ligji, në nenin 3 ceket limitet e të drejtave për tubime publike të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e lirisë dhe drejtave të njerëzve të tjerë, rendit ligjor, si dhe moralit dhe shëndetit publik. Përfaqësuesi i tubimit publik është i obliguar të raportoj mbajtjen e

² (DLA Piper, 2013) Comparison on the rights, limitations and procedures related to public gatherings and demonstrations across Europe: <http://www.dlapiperprobono.com/export/sites/pro-bono/downloads/pdfs/Public-Gatherings-and-Demonstrations-Comparison.pdf>

³ (Peters & Ley, 2014) Comparative Study: Freedom of Peaceful Assembly in Europe: http://www.venice.coe.int/files/Assemblies_Report_12March2014.pdf

⁴ OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights. (2010). *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*.: <https://www.osce.org/odihr/73405?download=true>

tubimit paqësore publik dhe protestave. Aplikimi për tubim paqësor dhe proteste publike dorëzohet tek stacioni i policisë në atë zonë ku parashihet të mbahet tubimi publik. Kërkesa dorëzohet 5 dite para mbajtjes së tubimit publik. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 7 kërkesa duhet të trajtohet deri 49 ore para fillimit të tubimit publik.

Këto janë disa nga predispozitat ligjore të shteteve të Sllovenisë dhe Kroacisë të cilat janë përdorur si reference gjatë përpilimit të këtij koncepti dokumenti.

Propozimet për ndryshimet në ligjin e tanishëm janë harmonizuar me udhëzuesin e Komisionit të Venedikut dhe ODIHR për tubime publike dhe janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kapitulli 3: Synimet dhe Objektivat

Synimi

Synimi i këtij koncepti dokumenti është që të rregullohet organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike, në pajtueshmëri të plotë me kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet dhe konventat ndërkombëtare, si dhe të harmonizohen masat ndëshkuese me ligjet tjera në fuqi.

Objektivi 1: Të plotësohet infrastruktura ligjore për tubimet publike në harmoni me parimet dhe praktikën ndërkombëtare që ndërlidhen me të drejtat e njeriut;

Objektivi 2: Menaxhimi efektiv i tubimeve publike përmes bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të organizuesve dhe autoriteteve shtetërore;

Objektivi 3: Ngritja e nivelit të llogaridhënies nga të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit dhe pjesëmarrësve të përfshirë në tubimet publike.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni Status Quo (asnjë ndryshim)

Do të vazhdojnë problemet me paraqitjen dhe marrjen e lejeve nga PK-ja për tubime publike po ashtu do të vazhdojnë apo rriten shpenzimet e institucioneve të zbatimit të ligjit pasi që forcat e

këtyre institucioneve përditë do të jene aktive dhe me kapacitete të plota njerëzore çdoherë ne gatishmëri për arsyes se tubimet publike nuk paralajmërohem sipas ligjit.

Mos lajmërimi i tubimeve publike sipas ligjit automatikisht do të thotë se nuk do të ketë edhe organizator dhe si rrjedhoja edhe ne rastet e tubimeve publike të dhunshme do të ketë edhe dëmtime (shkatërrime) të pronave publike dhe private do të ketë edhe të lënduar si nga ana e protestuesve po ashtu edhe nga ana e pjesëtareve të PK-së.

Sipas ligjit ne fuqi do të vazhdojnë problemet me efikasitetin e gjykatave, në mos do të përkeqësohen edhe më tepër për shkak të numrit të lëndëve të reja veprave penale dhe kundërvajtjeve që pritet të pranohen.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ligji Nr. 05/L-087 për kundërvajtje është miratuar më 5 gusht 2016, ndërsa është dekretuar me datë 23.08.2016 nga Presidenti, kurse ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017. Në dispozitat kalimtare ne nenin 167 të këtij ligji thuhet se: “Dispozitat për kundërvajtje që nuk janë në pajtim me këtë ligj, do të harmonizohen brenda afatit prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligj” që i bijnë që edhe Ligji për Tubime Publike duhet të harmonizohet me ligjin për Kundërvajtje që është ligje bazik.

Po ashtu në ligjin për tubime publike duhet të harmonizohen edhe disa nene me Kodin Penal, me theks të veçantë te masat ndëshkuese ku kryesisht përmenden pasojat dhe jo tentativat:

Neni 21 i ligjit për tubime publike, masat ndëshkuese, ne piken 4.1. thuhet se personi i cili bart armë dënohet me shumen prej 700 deri ne 1000 euro. Kjo nuk është ne harmoni me Kodin Penal ku neni 374 e përcakton se mbajtja ne pronësi, kontrollimi ose posedimi i armeve dënohet me gjobë deri ne 7.500 Euro ose me burgim deri ne 5 vjet.

Ne ligjin për tubime publike nuk është i përmendur shkaktimi i rrezikimit te përgjithshëm i cili ne baze të Kodit Penal nga neni 365 është i përcaktuar ne piken 1 ku thuhet se “kushdo që me veprime të rrezikshme apo mjete të rrezikshme shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dem të konsiderueshëm pasuror dënohet me burgim prej 6 muaj deri ne 5 vjet (p.sh. ne

turmat e dhunshme kjo gjënë zbatim ne rast të përdorimit të armëve, koktejeve të molotovit dhe mjeteve tjera të cilat mund të shkaktojnë rrezikim të përgjithshëm).

Po ashtu duhet të këtë plotësime sa i përket sanksioneve dhe gjobave të vëna pas tubimit qe janë masa më të përshtatshme se shqiptimi i restriksioneve para apo gjatë tubimit publik (p.sh pjesëmarrja në tubim të kundërligjshëm).

Disa shkelje që mund të sanksionohen me ligjin për tubime publike janë:

- Dështimi për të vepruar në pajtim me kushtet e përcaktuara për organizimin dhe pjesëmarrje në tubim paqësor;
- Pjesëmarrje në tubim të ndaluar paraprakisht;
- Mbjajta e armës apo gjësendeve tjera të ndaluara me ligj në tubim publik;
- Pengimi i një tubimi nga pjesëmarrësit tjerë.

Në ligjin aktual neni 11 është e ndaluar mbajta apo shitja e alkoolit qe në praktikë kemi raste të shumta qe përdoret edhe alkooli siç janë panairot, koncertet, festivalet, apo manifestimet e ndryshe (BeerFest, HardhFest etj) andaj duhet të rregullohet edhe kjo çështje.

Edhe pse ekziston Ligji për përkujdesjen ndaj kafshëve, Ligji për tubime publike duhet të rregulloj çështjen e Organizimit të tubimeve të garave me kafshë e posaçërisht: Garave me qen dhe Gjela (Kendeza) duke mos përjashtuar edhe gara me kafshë tjera dhe të parashihen edhe sanksione për organizatorët e këtyre garave dhe e pronarëve të këtyre kafshëve.

Përfundimisht, duke pasur parasysh qe ndryshimet e propozuara me larte nuk ndryshojnë substancialisht ligjin aktual, propozohet qe te këtë plotësim-ndryshim te ligjit ne fuqi.

Opsioni 3

Ndryshimi i qasjes ekzistuese te zbatimit

Me ndryshimin e legjislacionit, posaçërisht te ligjit për kundërvajtje ndryshon edhe zbatueshmëria e sanksioneve. Me qëllim te rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit ne zbatimin e këtij ligji, deri ne një shume te caktuar (500 euro) kundërvajtjet trajtohen nga Policia e Kosovës. Me hyrjen ne fuqi te ligjit për kundërvajtje, atëherë ne ligjin për tubime publike duhet te ndodhin ndryshime ne qëllim te harmonizimit te këtyre ligjeve. Si rrjedhojë, dispozitat për

kundërvajtjen që nuk janë në pajtim me këtë ligj, duhet të harmonizohen brenda afatit prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Si rezultat i mos-harmonizimit të ligjit për kundërvajtje me ligjin për tubime publike, ka pengesa për zbatimin e mirëfillte të këtij ligji.

Kapitulli 5: Përmbledhje e Opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Zbatimi i kornizës ligjore aktuale të paefektshme që merret në mënyrë të pamjaftueshme me Tubime Publike	Ndryshimi i politikës ekzistuese	Ndryshimi i qasjes ekzistuese
Segment i popullsisë / sektori / rajoni i synuar.	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës	Republika e Kosovës
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - portofol i qeverisë (kush), sektori privat, qytetarët.	MPB/PK, Sektori Privat, qytetarët e organizuar në grupe, etnitete, OJQ, Subjekte Politike	MPB/PK, Sektori Privat, qytetarët e organizuar në grupe, etnitete, OJQ, Subjekte Politike	MPB/PK, Sektori Privat, qytetarët e organizuar në grupe, etnitete, OJQ, Subjekte Politike
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	PK	PK	PK
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet në ligjet ekzistuese, zbatimi	Pa ndryshime	Ndryshimi ose plotësimi i ligjit për Tubime Publike	Ngritja e efikasitetit në zbatimin e masave ndëshkuese të

dhe dënimet.			parapara në ligjin aktual
Stimujt ose stimujt jo ekonomik - subvencione apo taksa.	Pa ndryshime	Me plotësim/ ndryshimin e këtij ligji, do të dekurajohen kundërvajtësit për moszbatimin e ligjit. Po ashtu, do të përshpejtohet procedura e shqiptimit dhe ekzekutimit të gjobave të parapara me plotësim/ ndryshimin e ligjit.	Nëse ndryshohet vetëm qasja, do të dekurajohen kundërvajtësit për moszbatimin e ligjit, pasi që do të rritet numri masave të shqiptuara dhe ekzekutimi i tyre.
Fushata të edukimit dhe komunikimit.	Pa ndryshime	MPB/PK, donatorët, mediat dhe format e tjera të edukimit (billborde, ligjërata dhe komunikimeve direkt me qytetare).	MPB/PK, donatorët mediat dhe format e tjera të edukimit (billborde, ligjërata dhe komunikimeve direkt me qytetare).
Udhëzimet dhe kodet.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Afatet kohore - kur opsioni bëhet efektiv.	Vazhdon zbatimi i ligjit aktual	Janar 2019	Vazhdon zbatimi i ligjit aktual

Kapitulli 6: Analiza e Opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1: Ligji aktual me ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve tjera, humb zbatimin e tij në politikat sanksionuese, gjithashtu nenet e caktuara janë të sanksionuara me ligjet tjera pozitive respektivisht të ligjit për kundërvajtje.

Opsioni 2: Me plotësim-ndryshimin e këtij Ligji do të harmonizohen dispozitat kundërvajtëse, politikat ndëshkuese, si dhe do të definojnë saktë dispozitat kundërvajtëse dhe penale duke u bazuar në Ligjin aktual për Kundërvajtje (dispozitat ndëshkuese për persona fizik dhe juridik) dhe Kodin Penal të Kosovës. Grupet apo komunitetet përfituese përfshijnë një numër të madh qytetash dhe institucionet përkatëse. Nen 1, përfitues është policia e Kosovës e cila me këtë plotësim-ndryshim e ka me të qarte dhe me të lehtë zbatimin e dispozitave ndëshkuese dhe menaxhimin e tubimeve publike. Nen 2, me supozimin se plotësim-ndryshimi bene me të qarte përgjegjësitë e policisë, ngrit vetëdijesimin e qytetareve dhe ndikon në rritjen e sigurisë publike, përfituesit kryesor janë qytetaret dhe bizneset të cilët nuk do të pësojnë nga protestat dhe tubimet e dhunshme.

Opsioni 3: Me ndryshimin e qasjes arrihen disa benefite për institucionet përkatëse, sidoqoftë këto ndryshime do të jenë të mangëta pa plotësim-ndryshimin e ligjit aktual. Rrjedhimisht, ndryshimi i qasjes është pjesë komplementare në drejtim të arritjes së rezultatit të dëshiruar. Prandaj, ndryshimi i qasjes si pjesë komplementare e plotësim-ndryshimit të ligjit aktual do të rezultojnë në organizim më të mirë të tubimeve publike, zvogëlim të incidenteve, rritje të sigurisë publike, si dhe vetëdijesim të masës.-

Pasojat negative

Opsioni 1: Mos ndryshimi i ligjit aktual nuk do të ketë përfitime, por vetëm pasoja negative për shkak të zbrazëtirave ligjore dhe mos zbatim të masave ndëshkuese dhe mos efikasitet të institucioneve që e zbatojnë këtë ligj.

Opsioni 2: Opsioni i propozuar nuk ka asnjë pasoj negative por është opsioni ideal, sepse do të ketë ndikim pozitiv në evitimin e zbrazëtirave ligjore, konkretisht në përcaktimin e detajeve të caktuara të kornizës ligjore në lidhje me përmbajtjen e Ligjit për Rend dhe Qetësinë Publike dhe harmonizimin e tij me Ligjin për Kundërvajtje dhe Kodin Penal.

Plotësim-ndryshimi i ligjit për tubime publike sjell vetëm rezultate pozitive, duke qartësuar pjesët e paqarta ligjore, specifikisht duke ndihmuar në detajizimin e kornizës ligjore sa i përket Ligjit për Tubime Publike. Vlen të përmendet, se ky plotësim-ndryshim shpejton ekzekutimin e masave/dënimeve - të ekzekutuara nga policia - e cila në të njëjtën kohë ka edhe përgjegjësi për animimin e qytetareve në vendimet për dënime. Në përgjithësi, ky plotësim-ndryshim rritë efikasitetin e zbatimit të ligjit aktual dhe përmirëson mangësitë me të cilat janë përballur deri me tash grupet e interesit (qytetarët dhe institucionet e zbatimit të ligjit).

Opsioni 3: Ndryshim i qasjes ekzistuese të zbatimit të ligjit aktual, nuk do të siguronte rezultatet e dëshiruara në zgjedhjen e problemeve që janë hasur në zbatim të masave ndëshkuese. Po ashtu, do të ketë vështirësi të vazhdueshme për zbatimin e masave ndëshkuese nga organet kompetente.

Efektet e shpërndarjes

Kostot

Për zbatimin e këtij opsioni të propozuar, nuk krijohen kosto shtesë buxhetore, përveç atyre të parapara tashmë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2014.

Tutje, asnjëri nga opsionet e hartuara nuk paraqet diferencë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve. Po ashtu, nuk pritet financim nga donatorët.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	Viti aktual - (do të thotë viti kur është bërë regjistrimi, varësisht nga viti i shpalljes së ligjit	Viti 2	Viti 3	Viti 4

)			
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve.	95,595,582 €			
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave.	-			
Financimi i pritur nga donatorët.				
Opsioni 2	95,595,582 €			
Fushata e vetëdijesimit/informimit	-			
Trajnimi i zyrtarëve, pronarëve dhe operatorëve të infrastrukturës kritike	-			
Zhvillimi i udhëzimit	-			
Financimi i pritur nga donatorët.	-			

Në vazhdim do të prezantojmë mjetet financiare të ndara në bazë të kategorive ekonomike duke përfshirë periudhën 2018 - 2020.

Tabela nr. 1: Tabela në kuadër të kufirit buxhetor 2018 - 2020 - PK-së

Nr. Re.	Kategoria ekonomike	2018	2019	2020	TOTALI
1	Nr. i Personelit	9149	9149	9149	
2	Paga dhe Mëditje	68,777,003 €	70,165,892 €	71,022,883 €	209,965,779 €
3	Mallra dhe Shërbime	12,357,956 €	12,893,663 €	13,429,335 €	38,680,954 €
4	Komunalit	1,360,250 €	1,260,250 €	1,260,250 €	4,200,750 €
5	Subvencione	1,291,129 €	1,291,129 €	1,291,129 €	3,573,387 €
6	Investimet Kapitale	11,809,244	9,445,983 €	10,331,544 €	34,751,552 €
	Totali	95,595,582 €	95,056,917 €	97,335,141 €	291,172,422 €

Kapitulli 7: Konsultimi

Si rrjedhojë e nevojës për rregullimin dhe plotësimin e ligjit aktual, ka lindur ideja për hartimin e këtij koncept dokumenti. Konsultimi i jashtëm është i parapare te behet sipas Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe Udhëzuesit për Procesin e Konsultimeve Publike (shtator

2011), ku palëve të lartë cekura, ua kemi dërguar draftin fillestar të këtij koncept dokumentit. Nga këto konsulta, është arritur përfundimi se ndryshimet e lartpërmendura janë më se të domosdoshme. Po ashtu, ky KD, para procedimit për miratim në Qeveri, do të dërgohet në konsultim paraprak ndërministror dhe në konsultim publik, përmes platformës së konsultimeve publike.

Gjatë hartimit të këtij Koncept dokument janë konsultuar grupet e interesit duke pasur edhe OJQ në grupin punues si përfaqësues.

Përgatitjes së këtij KD i ka paraprirë konsultimi me publikun dhe palët e interesit, përmes platformës elektronike qeveritar për konsultimeve me publikun.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Mos-ndryshimi i qasjes dhe i ligjit aktual kontribuon në mos ndryshimin e gjendjes aktuale dhe paraqet rrezik për përkeqësimin e situatës. Vështirësitë për të zbatuar këtë ligj e posaçërisht tek masat sanksionuese do ta zbehe punën e institucioneve të zbatimit të ligjit sa i përket tubimeve publike si dhe uljes së besueshmërisë kundrejt këtyre institucioneve. Për më tepër, në ligjin aktual ekzistojnë edhe zbrastira ligjore, paqartësi, dhe mos-harmonizim me Ligjin e ri për Kundërvajtje.

Opsioni 2: Në krahasim me dy opsionet tjera, ky opsion është ideali. Përmes plotësim-ndryshimit të ligjit do të behet: harmonizimi me ligjet e tjera, zvogëlohet mundësia për interpretime të ndryshme, lehtësohet puna e institucioneve përkatëse, ngritja e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave ndëshkuese dhe do të parandalohen rreziqet potenciale nga tubimet e tjera në të ardhmen.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes nuk arrin objektivat përfundimtare të këtij ligji. Ky opsion, sidoqoftë lufton status quo-n mirëpo nuk është i efektshëm sa plotësim ndryshimi i propozuar në opsionin 2.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Në bazë të hulumtimit, analizës dhe krahasimeve financiare, plotësim ndryshimit është opsion që do të qartësojë, harmonizojë dhe formësojë në tërësi ligjin e ri për tubime publike. Prandaj, me këtë plotësim ndryshim evitohet keqkuptimet mes institucioneve zbatuese. Po ashtu, do të harmonizojë këtë ligj me ligjet tjera, posaçërisht me ligjin për kundërvajtje, i cili është ligj bazik në fushën e kundërvajtjes. Për më tepër, ky opsion rrit efikasitetin dhe efektivitetin e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave sanksionuese.

Kapitulli 10: Komunikimi

Me rastin e miratimit të koncept dokumentit, Ministria e Punëve të Brendshme do t'i njoftojë palët e interesit, dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Njëkohësisht, përmes ueb-faqes së MPB-së, do të njoftohen edhe publiku i gjere për miratimin e këtij KD dhe për hapat e ardhshëm deri në miratimin e ligjit të ri.